



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 35, paragrafi 1, pika 1 dhe nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18); nenit 27-dh, paragrafi 4 dhe nenit 46, paragrafi 2 të Ligjit të Qarkullimit të Pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, 35/11, 11/12, 59/12, 166/12, 170/13, 153/15 199/15, 7/19 dhe 31/20), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut mori:

V E N D I M

për dorëzimin dhe publikimin e të dhënave për veprimtaritë e kryera në qarkullimin e pagesës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 88/21)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet detyrimi për dorëzimin e të dhënave për aktivitetet e kryera në qarkullimin e pagesës, përmbajtja, mënyra dhe afatet e dorëzimit së dhënave në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) dhe mënyra e publikimit të tyre nga Banka Popullore.
2. Njësitë raportuese për dorëzimin e të dhënave për aktivitetet e kryera në qarkullimin e pagesës (në tekstin e mëtejme: raportues) janë:
 - bankat, emetuesit e parasë elektronike, personat juridikë që përfshihen në sistemin e pagesave ose kryejnë shërbime të tjera në lidhje me pagesat, ndërmjetësit gjatë mikropagesave dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave (në tekstin e mëtejme: ofruesit e shërbimeve të pagesave) dhe
 - operatorët e sistemeve të pagesave.

II. LLOJE TË DHËNASH

3. Raportuesit, ofrues të shërbimeve të pagesave dorëzojnë të dhëna për:
 - llogaritë e pagesave;
 - kartelat për pagesa;
 - pajisjet që pranojnë kartela për pagesa;
 - qarkullimet e pagesave sipas tipit të instrumentit të pagesës, dhe
 - qarkullimet e pagesave sipas tipit të pajisjes.

Raportuesit janë të detyruar të dorëzojnë të dhënat e paragrafit 1, pikat 3, 4 dhe 5 të kësaj pike për vendet individuale të cilave u referohen.

4. Raportuesit, operator të sistemeve të pagesave dorëzojnë të dhëna për:
 - tipet e pjesëmarrësve në sistemet e pagesave, dhe

- pagesat e përpunuara nëpërmjet sistemeve të pagesave.
5. Raportuesit, ofrues të shërbimeve të pagesave janë të detyruar të dorëzojnë të dhëna për:
- numrin e përgjithshëm të tregtarëve dhe numrin e përgjithshëm të pikave tregtare në vend që janë klientë të ofruesit të shërbimit të pagesave dhe pranojnë kartat e tij;
 - kompensimet e pikave të shitjes që tarifohen nga tregtarët;
 - kompensimet që tarifohen nga zotëruesi i kartës së pagesës;
 - numrin e përdoruesve të llogaritësit personal dhe/ose telefonit celular për iniciimin e pagesave elektronike;
 - numrin e llogarive të transaksionit sipas strukturës së moshës dhe gjinisë dhe sipas ndarjes gjeografike në komuna;
 - numrin e kartave për pagesa sipas ndarjes gjeografike në komuna;
 - numrin e tregtarëve, pikat e shitjes, pajisjet në pikat e shitjes, bankomatet, degët dhe filialet sipas ndarjes gjeografike në komuna;
 - emrin e shërbimeve publike dhe të institucioneve shtetërore që mundësojnë pagesën pa para të gatshme në pikat e shitjes dhe
 - numrin dhe vlerën e qarkullimit të pagesave me karta për pagesa sipas strukturës së moshës.

III. MËNYRË DHE AFATE TË DORËZIMIT TË TË DHËNAVE

6. Raportuesit janë të detyruar t'i dorëzojnë të dhënat e pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi në bazë tremujore, në mënyrë elektronike, përmes sistemit elektronik të Bankës Popullore për statistikë pagesash, deri ditën e pesëmbëdhjetë të punës të muajit të parë të tremujorit aktual për tremujorin e mëparshëm.
7. Raportuesit janë të detyruar t'i dorëzojnë të dhënat e pikës 5 të këtij vendimi çdo vit, në mënyrë elektronike, përmes sistemit elektronik të Bankës Popullore për statistika pagesash, deri ditën e pesëmbëdhjetë të punës të janarit, për vitin e mëparshëm.
8. Të dhënat e dorëzuara në lidhje me raportuesit individualë janë të natyrës konfidenciale.

IV. PUBLIKIM I TË DHËNAVE

9. Banka Popullore i publikon të dhënat çdo tremujor, përkatësisht çdo vit, në formë të përmbledhur, në faqen e vete të internetit, në përputhje me kalendarin e publikimit të të dhënave, me përjashtim të të dhënave të pikës 5, nën pikat 3, 4

dhe 8, të cilat do të përdoren vetëm për qëllime analitike dhe nuk do të jenë lëndë publikimi.

Banka Popullore do të fillojë të publikojë të dhënat e pikës 5, nënpikat 5 dhe 6, të cilat i referohen ndarjes gjeografike sipas komunave, nga periodha raportuese që fillon më 2024.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

10. Guvernatori i Bankës Popullore përcakton llojin, përmbajtjen dhe mënyrën e dorëzimit të raporteve me të dhënat e pikave 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi.

Udhëzimi i paragrafit 1 të kësaj pike do të miratohet në afat prej një muaj nga hyrja në fuqi të këtij vendimi.

Në përputhje me pikën 5, nënpikat 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij vendimi, raportuesit dorëzojnë të dhëna vjetore nga periodha raportuese që fillon nga viti 2020. Të dhënat vjetore për vitin 2020 duhet të dorëzohen deri më 1 shtator 2021.

Të dhënat e pikës 5, nënpikat 5 dhe 6 do të dorëzohen nga komuna, në përputhje me adresën zyrtare të banimit të klientëve të regjistruar në sistemin e raportuesit. Nëse raportuesi nuk ka adresën zyrtare të banimit të klientëve, do të raportojë në komunën ku bën pjesë filiali/dega e raportuesit, ku mbahen llogaritë e transaksionit, përkatësisht kartat për pagesa dhe është i detyruar të informojë klientin për nevojën e përditësimit të të dhënave sipas adresës zyrtare të vendbanimit dhe t'i përditësojë deri më 31.12.2023. Për klientët që nuk i përditësojnë të dhënat në lidhje me adresën zyrtare të vendbanimit brenda afatit të caktuar, raportuesit janë të detyruar të paraqesin të dhëna për komunën ku bën pjesë filiali dega e raportuesit, ku mirëmbahen llogaritë e transaksionit të klientëve, përkatësisht kartat për pagesa të tyre.

11. Ditën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi, pushon së vlefshmi Vendimi për dorëzimin e të dhënave për aktivitetet e kryera në qarkullimin e pagesës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 250).

12. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa do të zbatohet nga 1 shtatori 2021.

V nr.02-15/V-3/2021
19 prill 2021
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska